



Planuar / Doretuar Punëno/Prodato Received/Delivered	22.04	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOPSACK	1954/2021		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.227/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.3007/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.497/2019 të datës 26.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga Evlija Celebi, Nr.54, D9, Komuna e Mitrovicës, kundër Vendimit me numër 01-120/08-0051262-2/19 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.497/2019 e datës 26.08.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 01-120/08-0051262-2/19 i datës 12.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me date 20.05.2019, ka nxjerr vendim me numër reference 01-118/01-0042322/19Nr.-02 2068 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për ankuesen, „Zyrtare për Pronë” në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ne Komunën e Mitrovicës së Jugut. Me këtë vendim i është njohur e drejta e një pagë të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankueses i është kompensuar në me datën 09.09.2019

Ankuesja më datë 14.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut për për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit dhe pagesën e shpërblimit jubilar, duke u bazuar në nenin 53 të marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut me datë 12.07.2019 ka nxjerr Vendim (në emër të KZAK-së i është përgjigjur Kryetari i KZAK-së) me numër 01-120/08-0051262-2/19 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër 01-120/08-0051262-2/19 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut, më datë 26.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3881/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.08.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ndërsa më datë 11.09.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 14.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.3007/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 14.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3881/2019 të datës 26.08.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-120/08-0051262-2/19 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Vendimi i datës 20.05.2019 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Pliko postare R 7469809; Kërkesa për përgjigje e datës 27.08.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 11.09.2019; Ankesa e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës e datës 14.06.2019; Akt emërimi i ankueses i datës 01.08.2013; Dëshmi për pagesën e pagës përcjellëse të pensionimit e datës 09.09.2019; Urdhër obligimi për pagesë e datës 29.08.2019; Urdhër blerjeje e datës 03.09.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 08.08.2019; Kërkesa e datës 07.08.2019; Pliko postare R 7118837, Njoftimin e datës 14.11.2019 për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.3007/19 i datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se organi i punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, duhet t'i bëjë pagesën në vlerën e tri (3) pagave me rastin pensionimit, dhe pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej dy paga përcjellëse dhe pagave jubilarë, ka konstatuar se Marrëveshja Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 ndërsa ka një kohëzgjatje prej tri vitesh dhe sipas dispozitave të nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kjo marrëveshje ka qenë në fuqi deri më datë 01.01.2018, ndërsa ankuesja sipas Vendimit me numër reference 01-118/01-0042322/19 të datës 20.05.2019 është pensionuar me date 27.06.2019, rrjedhimisht nuk mund të bëhet kompensimi sipas kësaj marrëveshje pasi e njëjta nuk është në fuqi, mbi këtë bazë pretendimi është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesja ka qenë nëpunëse civile në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe që statusi i nëpunësve civilë si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet, rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e pagës për nëpunësit civilë, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me të cilat përveç tjerash në mënyrë decisive përcaktohet edhe kompensimi i nëpunësve civilë me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë është përcaktuar që nëpunësit civilë, përveç tjerash kanë të drejtat në vijim:... „2.2. pagesën për shkak të pensionimit dhe 2.3. shpërblimi i përvjetorit (jubile).

Po ashtu me dispozitat e nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: „Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit“.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të ofruara nga organi i punësimit, gjegjësisht Urdhër pagesës të Thesarit datës 09.09.2019, konstaton që ankueses i është bërë kompensimi në shumën bruto prej 495.32 Euro, si pagesë në shumën e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktet e lartëcekura konstatoi që ankueses i është bërë kompensimi me rastin e pensionimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, dhe për këtë arsye vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar, pasi që kërkesa për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit është e bazuar në kontratën kolektive, e cila nuk zbatohet sepse nuk është në fuqi nga data 01.01.2018.

Në lidhje me kërkesën e ankuesit për pagesën e shpërblimit jubilar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: „Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”.

Duke marr parasysh që ankuesja në ankesën me numër protokolli 3381 të datës 26.08.2019, ka theksuar që „Nuk me është njohur fare e drejta në shpërblime jubilarë edhe pse kam mbi 20 vjet përvojë pune (16 vjet e 4 muaj e 16 dite deri me date 31.12.2014 sipas Vendimit të datës 06.07.2015 mbi pranimin e përvojës së punës dhe që nga viti 2001 në marrëdhënie pune pandërprerë në Komunën e Mitrovicës) Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që ankuesja ka pasur të drejtë të parashtroj kërkesën për pagesën e shpërblimit jubilar pas arritjes së kohës „prej dhjetë (10) vjetësh pune” ashtu siç është përcaktuar saktë me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ku është përcaktuar që: „Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”, e që nënkupton që kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankuesja këtë kërkesë ka pasur të drejtë të parashtroj para gjithsejtë tetë (8) viteve, gjegjësisht brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur e ka arritur kohën „prej dhjetë (10) vjetësh pune” pandërprerë në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-120/08-0051262-2/19 të datës 12.07.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, në rastin e nxjerrjes së vendimit me numër reference 01-118/01-0042322/19 të datës 20.05.2019 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse më rastin e pensionimit, është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar ankueses _____ e drejta në kompensim e tri (3) pagave përcjellës pas arritjes se moshës se pensionimit, i takon në pajtim me nenin 53 të Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive, mirëpo kjo Kontratë, nuk është në fuqi nga data 01.01.2018.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.3007/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.227/2021

Hysni MUSTAFA

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës së Jugut.; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

